

SBASHK Arsimimi sot

Dhjetor, 2023

Gazeta elektronike

Angazhime konkrete të Qendrës Amerikane të Solidaritetit dhe SBASHK-ut Një aktivitet në shërbim të arsimit që u vlerësua lartë



Pas shumë aktiviteteve të përbashkëta sindikale SBASHK-u dhe Qendra Amerikane e Solidaritetit kanë bërë bashkë në tryezën tematike “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës” përfaqësues të MASHTI-t, Ministrisë së Shëndetësisë, të Komisionit Parlamentar për Arsim, BSPK, Odës së Mjekëve e të Infermierëve, të Këshillit të Prindërve, të mediave dhe të Organizatave jo qeveritare dhe përfaqësues të nxënësve.

Në hapje të tryezës, që u vlerësua drejt nga pjesëmarrësit si hap i qëlluar drejt përgatitjes së Konferencës së muajt shkurt 2024 me temën e njëjtë e me numër të madh përfaqësuesish vendor e ndërkombëtar ... (faqe 4)

SBASHK me një aktivitet domethënës në Pejë

Trajnim për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës



Duke realizuar vullnetin e kolegeve e kolegëve nga disa shkolla të Pejës Amerikane ... (faqe 7)

Çka thonë anëtarët e stafit qendror?

Do të vazhdojmë me angazhimet në shërbim të anëtarësisë ... (faqe 3)

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut mbajti takimin përmbyllës Vit me plot sfida, por edhe me arritje të shumta



SBASHK po vazhdon me aktivitetin ... (faqe 5)

Në shenjë respekti për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë Punëtor dhe sindikalist i vitit 2023 në SBASHK u shpall Ymer Ymeri



Në hapje të takimit përmbyllës të ... (faqe 6)

Editorial

Rrugëtim i mbarë i SBASHK-ut edhe në vitin 2023



Tre muajt e fundit të vitit 2022 ishin me plot sfida për SBASHK-un. Pas pesë javë grevë në të gjitha institucionet arsimore, më 1 tetor po niste procesi mësimor. Duket se kjo nuk e gëzoi Qeverinë sepse ajo në vend që të ulej me përfaqësuesit e SBASHK-ut e të shohin se çfarë mund të bëjnë në shërbim të arsimit, nuk ndaluan me veprime kërcënuese e me qëllim që ta shuanin këtë sindikatën tonë. Deklarime të pamatura e të ftohta ishin ato se të punësuarve në arsim nuk do t'i procedohen pagat për muajin shtator. Qeveria nuk u ndal me kaq po “zbuloi” platformën eKosova pasi kishte shlyer gjithë të regjistruarit në sindikatë. Pritjet e tyre ishin që kjo pengesë nuk do të kalohej dot dhe kështu sindikatat, duke mos arritur numrin e duhur të anëtarësisë, do të hiqeshin fare nga regjistri, pra nuk do të ekzistonin më. Mirëpo, edhe kjo pengesë e krijuar qëllimshëm nga Qeveria, nuk u dha rezultate sepse mijëra e mijëra punëtorë të arsimit, që nga çerdhet e deri në Universitete tejkaluan këtë sfidë dhe dëshira e dikujt për të shuar SBASHK-un u kthye në dëshpërim për ta. Edhe viti 2023 e tregoi se është e vërtetë thënia popullore se miku i mirë shihet në ditë të vështira. Duke çmuar shumë angazhimet e SBASHK-ut dhe përpjekjet e mëdha në realizim të detyrave konkrete sindikale Qendra Amerikane e Solidaritetit dhe shumë sindikata simotra bashkë me Unionin e Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe Internacionalja Botërore e Arsimit

i qëndruan pranë sindikatës sonë duke e mbështetur e duke organizuar aktivitete të përbashkëta sindikale që nxjerrin detyra konkrete në rrugëtimin e mbarë përmes furtunave të kohës. SBASHK organizoi bashkë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit një varg aktiviteteve sindikale dhe vazhdojnë me bashkëpunimin edhe për çështje arsimore. SBASHK organizoi shumë takime me veprimtarë sindikalë e me anëtarësinë kudo në Kosovë, kreu me sukses edhe trajnime me mësimdhënës në disa komuna të Kosovës. Po ashtu mori pjesë edhe në Kongrese të sindikatave simotra e në takime e Konferenca të rëndësishme organizuar nga ETUCE e EI kudo në Evropë e në tërë botën. Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këto aktivitete vendore e ndërkombëtare kanë marrë përvojë, por edhe kanë bartur përvojë nga veprimtaria e suksesshme e sindikatës sonë nëpër vite e dekada. SBASHK-u edhe në vitin 2023 realizoi me sukses aktivitetin tradicional për organizimin e pushimeve për qindra anëtarë e anëtarë nga e tërë Kosova në bregdetin shqiptar, pushues këta që përzgjidhen nga shoqatat e tyre sindikale nëpër institucionet arsimore e kulturore të Kosovës. Një moment që është përcjellë me emocione e falënderime është edhe aktiviteti me veteranët e SBASHK-ut. Ky aktivitet i bëri bashkë ata që në vite e dekada kanë dhënë kontribut të lartë në zhvillimin e suksesshëm të gjithë aktiviteteve të SBASHK-ut. SBASHK-u zhvilloi edhe shumë angazhime e aktivitete të tjera, të cilat lexuesi mund t'i kujtojë duke lexuar gazetën vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2023” e ne ju kërkojmë falje nëse na ka ikur ndonjë gabim i vogël gjatë përgatitjes së shkrimeve për gazetën vjetore.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtarë e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Çka thonë anëtarët e stafit qendror?

Do të vazhdojmë me angazhimet në shërbim të anëtarësisë



Rrahman Jasharaj:

Edhe në vitin 2023 jemi angazhuar për të realizuar detyrat konkrete. Kemi vizituar shumë nga komunat dhe jemi takuar me kryetar e përfaqësues të institucioneve dhe me kryetarë të shoqatave duke bashkëbiseduar e duke marrë ide e propozime konkrete për rrugëtimin tonë. Në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit kemi zhvilluar një varg aktivitesh sindikale për ta forcuar edhe më shumë zërin sindikal e po ashtu kemi marrë një iniciativë, që u vlerësua shumë, për të bërë bashkë në një tryezë palët që ndërlidhën me arsimin e për t'u përgatitur bashkërisht për Konferencën tematike, që do të mbahet në shkurtin e vitit 2024. Përgëzoj stafin qendror, kryesinë, kryetarët e nivelit dhe gjithë anëtarësinë për angazhimet dhe ruajtjen e e unitetit. Gëzuar viti 2024!



Vjollca Shala:

Ishte vit me plot sfida, por në SBASHK nuk u ndalëm me angazhimet. Ishim vazhdimisht në takime me veprimtarë sindikalë duke debatuar e bashkëbiseduar me të gjithë çështjet aktuale. Në shumë komuna janë realizuar me sukses dhjetëra trajnime bazuar në vullnetin e anëtarësisë. SBASHK-u u përfaqësua në mënyrë të denjë edhe në aktivitete sindikale ndërkombëtare dhe në takime treguam për situatën aktuale në arsimin e Kosovës, për sfidat me të cilat po përballemi dhe gjithmonë nga udhëheqësit më të lartë të ETUCE dhe EI morëm përkrahje e mbështetje maksimale dhe vlerësime të larta për angazhimet tona.



Ymer Ymeri:


Duke qenë koordinator për organizim të brendshëm i SBASHK-ut kam organizuar takime të përditshme pune me stafin dhe kemi caktuar bashkërisht detyra ditore, të cilat i kemi realizuar duke ndihmuar njëri-tjetrin. Kemi bërë vazhdimisht përgatitje me kohë edhe për mbajtjen e trajnimeve duke u bazuar në

kërkesat e anëtarësisë, që arrinin përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikalë dhe duke falënderuar edhe përkushtimin e trajnerëve ky aktivitet ka pasur gjithmonë rrjedhë të mbarë. Po ashtu me sukses ka përfunduar edhe aktiviteti tradicional për pushimin e një numri të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve tonë, që janë përzgjedhur nga shoqatat sindikale. Ishte aktivitet që kërkonte shumë angazhime, por bashkërisht me stafin jemi angazhuar me kohë dhe jemi ndjerë shumë të lumtur kur pushuesit kanë qenë shumë të kënaqur dhe kanë vlerësuar lart angazhimin tonë. Kemi zhvilluar aktivitete të shumta sindikale në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit dhe kemi forcuar bashkëpunimin me shumë sindikata simotra nga Ballkani, Evropa e shtete të botës.



Afërdita Mirena:

Në stafin qendror të SBASHK-ut kemi mbajtur takime çdo ditë duke bashkëbiseduar e duke caktuar detyra konkrete dhe jemi munduar maksimalisht t'i realizojmë ato. Kam pasur komunikim të vazhdueshëm me kryetarët e nivelit komunal, por edhe me shumë anëtarë të sindikatës sonë dhe kemi realizuar kërkesat e tyre sindikale. Gjatë gjithë vitit kemi pasur detyra të shumta dhe i kemi realizuar me sukses fal edhe atmosferës së mrekulluar dhe bashkëpunimit të anëtarëve të stafit duke ndihmuar njëri-tjetrin kur detyrat është dashur të kryhen brenda afateve shumë të shkurtra.



Nezafete Jakupi:

Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi mes anëtarëve të stafit dhe korrektësia me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve ka bërë që edhe në vitin 2023, edhe përkundër shumë sfidave, të jemi në nivel të detyrës. Bashkërisht jemi angazhuar për të realizuar gjithë detyrat dhe me sukses janë realizuar aktivitetet e parapara. U realizuan me sukses shumë trajnime nëpër komuna. Kishte rrjedhë të mbarë edhe aktiviteti tradicional i pushimeve në bregdetin shqiptar për më shumë se 400 anëtare e anëtarë të SBASHK-ut. U

realizuan shumë takime me veprimtarë sindikalë nëpër komuna dhe aktivitete sindikale në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit.



Vlora Rexhepi Berisha:

Në vitin 2023 kemi vazhduar me angazhimet dhe realizimin e detyrave konkrete. Krahas aktiviteteve të shumta brenda në Kosovë, kemi vazhduar të mbajmë komunikim të rregullt edhe me Unionin e Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), me Internacionalen Botërore të Arsimit (EI), por edhe me sindikata simotra nga shumë shtete të botës. Në kuadër të këtij angazhimi dhe kemi këmbyer informacione për situatën aktuale në arsim, por edhe për aktivitetet që ishin të planifikuara të mbahen. Kjo na ka mundësuar që të jemi aktiv edhe në aktivitetet ndërkombëtare sindikale, në të cilat SBASHK-u është përfaqësuar në

mënyrë të denjë dhe ka dhënë ide konkrete, por edhe ka sjellë përvoja të shumta të angazhimeve sindikale në shtetet tjera.



Blendor Shatri:

Edhe në vitin 2023 kam pasur shumë vizita nga mësimdhënës nga e tërë Kosova. Ata kanë ardhur të marrin këshilla juridike për çështje të caktuara. Po ashtu nga mysafirët e mi më të dashur edhe këtë vit kanë qenë punëtorët e arsimit që me vite e dekada kanë dhënë kontribut të çmuar në arsimimin e edukimin e brezave dhe tani janë pensionuar. Dua të theksoj se stafi qendror në takimet e përditshme ka debatuar për gjithë çështjet dhe janë marrë detyra konkrete, të cilat edhe janë realizuar. Gjatë gjithë vitit kemi qenë të mobilizuar dhe detyrat e caktuara, që kanë kërkuar angazhime shtesë, i kemi kryer bashkërisht gjithë anëtarët e stafit qendror.

Gjatë muajit

Angazhime konkrete të Qendrës Amerikane të Solidaritetit dhe SBASHK-ut **Një aktivitet në shërbim të arsimit që u vlerësua lartë**

Pas shumë aktiviteteve të përbashkëta sindikale SBASHK-u dhe Qendra Amerikane e Solidaritetit kanë bërë bashkë në tryezën tematike “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës” përfaqësues të MASHTI-t, Ministrisë së Shëndetësisë, të Komisionit Parlamentar për Arsim, BSPK, Odës së Mjekëve e të Infermierëve, të Këshillit të Prindërve, të mediave dhe të Organizatave jo qeveritare dhe përfaqësues të nxënësve.



Në hapje të tryezës, që u vlerësua drejt nga pjesëmarrësit si hap i qëlluar drejt përgatitjes së Konferencës së muajt shkurt 2024 me temën e njëjtë e me numër të madh përfaqësuesish vendor e ndërkombëtar, drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit, Steven McCloud ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në Kosovë e pastaj ka treguar për angazhimet e Qendrës, që ai përfaqëson.



McCloud është shprehur se ndjehet mirë duke parë bashkë në këtë tryezë përfaqësuesit e institucioneve, SBASHK-ut, Parlamentit, mediave e shoqërisë civile.

Zëvendës ministri i Ministrisë së Shëndetësisë Arsim Berisha, kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim Gola, përfaqësuesja e MASHTI-t Donikë Kastrati, Kryetari i BSPK Atdhe Hykolli, i Këshillit të Prindërve Besnik Dragusha, ai i Këshillit të Nxënësve Ditjon Fetahu, profesoresha nga Departamenti i Psikologjisë Zamira Hyseni Duraku, Dr.Zef Komoni nga Oda e Mjekëve, drejtori ekzekutiv i Institutit EdGuard Rinor Qehaja, drejtorja e DKA-së së Prizrenit Luljeta Veselaj Guta, Donika Shahini Lami nga Oda e Infermierëve, Hana Zylfiu Haziri nga Qendra Arsimore e Kosovës, Bruna Hylviu nga Qendra Amerikane e Solidaritetit, Vjollca Shala dhe Ymer Ymeri nga SBASHK, përfaqësuesi i mediave dhe ai i nxënësve kanë dhënë kontribut me vlerë në këtë tryezë duke nxjerr përfundime e duke përcaktuar temat konkrete që do të debatohen në Konferencën ndërkombëtare të muajit shkurt e në të cilën pritet të marr pjesë edhe drejtorja e përgjithshme e Qendrës Amerikane të Solidaritetit Shawna Bader-Blau dhe drejtorja e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Susan Flocken.



Në mbyllje të kësaj tryeze kryetari Rrahman Jasharaj ka përgëzuar stafin e SBASHK-ut për gjithë angazhimet për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti dhe ka falënderuar drejtorin McCloud dhe gjithë pjesëmarrësit në këtë tryezë për debatin përmbajtësor dhe kontributin me vlerë, që do të jetë ndihmesë në përgatitjen me kohë të Konferencës ndërkombëtare për kujdesin ndaj shëndetit mendor në shkollat e Kosovës, që do të organizohet nga SBASHK dhe Qendra Amerikane e Solidaritetit e do të mbahet në shkurtin e vitit 2024.



Këshilli Drejtues i SBASHK-ut mbajti takimin përmbyllës Vit me plot sfida, por edhe me arritje të shumta

Në sallën e takimeve të Qendrës së studentëve u mbajt takimi përmbyllës i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut në të cilin u raportua fillimisht për aktivitetet sindikale për vitin 2023 në nivel të komunave, të universiteteve dhe në nivelin qendror.



Pas kësaj u debatua edhe për aktivitetet në vitin 2024, për rrjedhën e regjistrimit në e-Kosova, për raportin e shpenzimeve janar-nëntor, që ishte aprovuar nga Kryesia, e që u aprovua edhe nga Këshilli Drejtues.



Para se të kalohej në këto pika të rendit të punës kryetari Jasharaj ka përshëndetur anëtarët dhe anëtarët e Këshillit Drejtues duke përgëzuar kolegun Kadri Hyseni, që është zgjedhur kryetar i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Vushtrrisë duke zëvendësuar kolegun Visar Sadriu, i cili ka kaluar në detyrën e re. Pas kësaj kryetari ka deklaruar para pjesëmarrësve të këtij takimi se duke përgatitur gazetën “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2023” ka vërejtur se në çdo aktivitet ka qenë i angazhuar kolegu ynë Ymer Ymeri dhe prandaj ka kërkuar edhe votën e Këshillit Drejtues që Ymer Ymeri të shpallet punëtor i vitit, apo sindikalist i vitit. Pjesëmarrësit në këtë takim kanë aprovuar me votën e tyre këtë propozim të kryetarit Jasharaj.



Në vazhdim është bashkëbiseduar për angazhimet në nivel komunal, të universiteteve dhe nivelin qendror. Kryetari Jasharaj ka bërë një pasqyrim të aktiviteteve në nivel qendror, kurse kryetarët kanë kujtuar aktivitetet në komunat e tyre dhe në universitete.

Në vazhdim të takimit është debatuar për planifikimin e aktiviteteve për vitin 2024 dhe janë dhënë ide konkrete për angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Duke debatuar rreth rrjedhës së regjistrimit në e-Kosova dhe është vlerësuar se pas angazhimeve dhe punësve me veprimtarët sindikal bashkë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit numri i të regjistruarve është duke u shtuar, por ka raste të shumta që i punësuar regjistrohet dhe ka dëshmi, por kuota nuk ju ndalet. U tha se gjithë kjo, pra platforma dhe kjo që po ndodh me mos ndalesën e kuotës janë bërë e po bëhet për të penguar aktivitetin sindikal.



Raportin e shpenzimeve janar-nëntor 2023, që e kishte aprovuar Kryesia e SBASHK-ut, u prezantua nga zyrtarja për financa Nezafete Jakupi. Menaxheri për financa e administratë Ymer Ymeri ka dhënë sqarime për secilën

vijë buxhetore. Këshilli Drejtues njëzëri ka aprovuar Raportin e prezantuar të shpenzimeve janar-nëntor 2023 duke u pajtuar që raportit t'i shtohet edhe pjesa për muajin dhjetor. Po ashtu do të bëhet auditimi i brendshëm edhe auditimi i jashtëm.



Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë zhvilluar pastaj debat duke u ndalur të momente të veçanta të aktiviteteve në komuna dhe universitete.

Pas përfundimit të këtij takimi është organizuar një drekë modeste për pjesëmarrësit e takimit në shenjë respekti për angazhimet gjatë gjithë vitit 2023.



Në shenjë respekti për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë **Punëtor dhe sindikalist i vitit 2023 në SBASHK u shpall Ymer Ymeri**



Në hapje të takimit përmbyllës të Këshillit Drejtues kryetari Rrahman Jasharaj ka përshëndetur pjesëmarrësit e pastaj u është drejtuar me fjalët: “Kolege e kolegë duke përgatitur gazetën vjetore Rugëtimi i SBASHK-ut 2023 vërejtja se në çdo aktivitet ka qenë i angazhuar kolegu ynë Ymer Ymeri dhe prandaj ju propozoj që ta shpallim punëtor, gjegjësisht sindikalist të vitit 2023”.

Anëtarët e Këshillit Drejtues e kanë vlerësuar këtë propozim si të qëlluar dhe me votë unanime e kanë shpallur koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri punëtor, gjegjësisht sindikalist të vitit në SBASHK. Kryetari Jasharaj ia dorëzoi në një ceremoni rasti këtë titull sindikalistit të vitit duke e përgëzuar dhe duke e falënderuar për gjithë angazhimet dhe përkushtimin në realizimin e aktiviteteve sindikale në shërbim të anëtarësisë.

SBASHK me një aktivitet domethënës në Pejë Trajnim për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës

Duke realizuar vullnetin e kolegeve e kolegëve nga disa shkolla të Pejës stafi qendror në koordinim me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, Isuf Lajçi kishin bërë gjithë përgatitjet për të nisur me trajnimin “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës”. Ky aktivitet po zhvillohet në ambientet e Qendrës Burimore “Xheladin Deda”. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Pejës Isuf Lajçi, veprimtarja sindikale Lumnije Berisha dhe trajnerja Drita Kamberi janë takuar me drejtorin e këtij institucioni të dalluar arsimor Xhavit Kastrati dhe me kryetarin e shoqatës sindikale Gani Gashi.



Kryetari Jasharaj ka falënderuar drejtorin Kastrati dhe mësimdhënësin Isuf Ahmetaj për angazhimet në krijimin e kushteve për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. Pas

kësaj ata kanë marrë pjesë në nismën e trajnimit. Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, Isuf Lajçi ka shprehur respekt për angazhimet e



stafit qendror dhe pastaj ka shpalosur disa nga aktivitetet sindikale, që janë zhvilluar në Pejë gjatë gjithë vitit 2023. Kryetari Jasharaj ka përgëzuar pjesëmarrësit, që edhe në ditë vikendi po bëhen pjesë e këtyre aktiviteteve, duke veçuar se ky është një trajnim i veçantë ngase përgatit mësimdhënësit për t'u përballur me sfidat e kohës e në përpjekje për të mbrojtur nxënësit nga format e rrezikshme të punës. Ai ka falënderuar trajneren Drita Kamberi për angazhimin duke u shprehur i sigurt se trajnimi do të ketë rrjedhë të mbarë dhe se për këtë do të ndihmojnë edhe pjesëmarrësit përmes angazhimit maksimal dhe bashkëbisedave e debateve që do të zhvillojnë për temat kyçe të këtij trajnimi.

Së shpejti mund ta lexoni gazetën “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2023” Ngjarje e aktivitete të renditura sipas muajve

Të nderuara anëtare, të nderuar anëtarë të SBASHK-ut me qëllim të informimit të plotë për gjithë angazhimet e SBASHK-ut stafi qendror ka botuar lajme të përditshme në facebook e ueb faqe e pastaj ngjarjet kryesore të një muaji i ka publikuar në gazetën “Arsimimi sot”. Me qëllim që aktivitetet dhe ngjarjet kryesore t'i keni bashkë dhe të ktheni kujtesën nëpër gjithë muajt e vitit 2023 kemi përgatitur gjithë materialet dhe se shpejti mund të lexoni gazetën vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2023”. Jemi munduar që ngjarjet t'i prezantojmë njëherë pas tjetrës sipas kohës që kanë ndodhur duke nisur nga ato të muajit janar e për të ardhur deri të ngjarjet e veprimtaritë kryesore të muajit dhjetor. Kush punon edhe mund të gabojë dhe prandaj ne ju kërkojmë falje lexuesve nëse hasin në ndonjë gabim të vogël drejtshkrimor. Qëllimi ynë ishte që ngjarjet, angazhimet dhe veprimtaritë sindikale t'i kemi të shënuara në një vend dhe mos t'ia lëmë harresës. Ju përshëndesim duke ju uruar Vitin e Ri me shpresë se do të ju sjell momente të bukura dhe shumë arritje e suksese. Gëzuar!

